



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.9/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas detyrës zyrtare, me datë 30.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHEN hetimet disiplinore ndaj gjyqtarit H.G, për shkelje të supozuar disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2. 5 të Ligjit mbi Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Me datë 21.09.2023, nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë komplet lënda C.nr.656/21 e paditësit P.S, nga K., të cilin e përfaqëson avokati L.P, nga K. kundër të paditurit GJ.S, nga K., të cilin e përfaqëson avokat A.J, nga P., është përcjellë te Kryetari i Gjykatës për të vendosur lidhur me kërkesën të autorizuarit të paditësit të parashtruar në seancën e datës 08.09.2023, për përjashtimin e gjyqtarit H.G me pretendimin se me kërkesën e palës së tij kërkon përjashtimin e gjyqtarit me arsyetimin se, citoj “*..sipas pretendimeve të paditësit, i padituri i ka thënë kinse gjyqtarit i kam dhënë 5000 euro, këto fjalë i padituri ja ka thënë paditësit në prezencën e bashkëshortes së paditësit dhe se i padituri i ka thënë paditësit se gjyqtari ka me të qu në burg për jetë dhe këtë çështje e ke kot.*”

Kryetari i Gjykatës, pasi ka rënë në dijeni lidhur me deklarinimin e paditësit P.S, të parashtruar përmes të autorizuarit të tij avokatit L.P, me datë 25.09.2023, duke vepruar konform nenit 6 par.5 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, çështjen ia ka referuar Prokurorisë Themelore në Pejë për të vlerësuar ekzistimin e mundshëm të veprës penale.

Po ashtu, me datë 25.09.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në cilësinë e autoritetit kompetent konform nenit 6 par.5 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës se Kryetari i Gjykatës, si Autoritet Kompetent për veprim ndaj shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve, në kuptim të nenit 12 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas detyrës zyrtare ka filluar mbledhjen dhe vlerësimin e provave për shkelje të mundshme disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.5 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve nga ana e gjyqtarit H.G.

Gjyqtari H.G, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim me datë 20.09.2023 e të plotësuar me datë 11.10.2023, ka theksuar se në seancën e datës 08.04.2022, para se të filloj seanca, në prezencën e palëve e ka pyetur të paditurin se a ka deklaruar ai se gjyqtarit kinse ja keni dhënë shumën prej 5000 euro, informatë të cilën gjyqtari e ka marrë nga jashtë, me këtë rast i autorizuari i të paditurit, avokati N.S, ka reaguuar duke e pyetur palën e tij pse nuk e ka informuar për këtë çështje dhe ka revokuar autorizimin e tij si dhe është larguar nga seanca. Me pëlqimin e palëve, seanca ka vazhduar të mbahet pa prezencën e avokatit ndërsa, i padituri ka deklaruar se nuk është e vërtetë

se ka thënë diçka të tillë andaj, me pëlqimin e palës paditëse dhe të autorizuarit të tij seanca ka vazhduar. Në seancën e datës 08.09.2023, ku paditësin e ka përfaqësuar avokati L.P ndërsa, të paditurin avokati A.J, në fund të seancës paditësi e ka marrë fjalën dhe përmes të autorizuarit të tij avokatit L.P, ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit ngase sipas pretendimeve të paditësit, i njëjti ka deklaruar se i padituri i ka thënë kinse gjyqtarit ia ka dhënë 5000 euro, ku këto fjalë i padituri ja kishte thënë paditësit në prezencë të bashkëshortes së tij e gjithashtu, i ka thënë se “gjyqtari ka me të qu në burg për jetë dhe këtë çështje e ke kot”. Lidhur me këto deklarime, gjyqtari me përgjegjësie penale, materiale dhe morale ka deklaruar se me palët ndërgjyqëse asnjëherë nuk është takuar jashtë gjykatës dhe atë vetëm për seanca.

Me datë 27.11.2023, Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda ka sjellë Raportin PPN/I.nr.221/2023, të datës 24.11.2023 për mbylljen e rastit të iniciuar sipas Njoftimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, të datës 25.09.2023, me arsyetimin se Njësi për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit – DHKEK në Pejë, duke vepruar sipas autorizimeve të Prokurorisë Themelore në Pejë, kanë marrë deklaratat e dëshmitarëve P.S, GJ.S, H.S dhe A.G dhe pas analizimit të deklaratave të tyre së bashku me shkresat e tjera të lëndës kanë arritur në përfundim se nuk ka elemente për iniciimin e procedues penale për vepër penale marrje e ryshfetit nga neni 421 i KPRK-së apo ndonjë veprë tjetër që ndiqet sipas detyrës zyrtare, për faktin se nuk është vërtetuar me asnjë fakt se H.G, duke qenë gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë, ka pranuar para në mënyrë që të veproj në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare apo ti sjellë përfitim në ndonjë mënyrë personit tjetër.

Kryetari i Gjykatës pas zhvillimit të hetimeve dhe vlerësimit të të gjitha provave ka vlerësuar se nuk ka bazë për të parashtruar kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarit H.G, pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës pasi ka gjetur se deklaratimet e të autorizuarit si të vetme dhe të pambështetura në asnjë provë nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës disiplinore.

Andaj, nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD.nr.9/23, me datë 30.11.2023

Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit H.G*